



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 10.12.2024

**Lënda:** Parashtrime përfundimtare të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 10.12.2024, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 767, datë 29.5.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Sofia Zhilla

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Komisioneri Publik, në analizim të rrethanave ligjore dhe faktike të rastit konkret, legjislacionit të zbatueshëm dhe jurisprudencës së Kolegjit, ka konstatuar se, në momentin e protokollimit pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, të vendimit nr. 767, datë 29.5.2024, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e paraqitur, znj. Sofia Zhilla gëzonte statusin e subjektit të rivlerësimit.

Rivlerësimi kalimtar i subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pika 3 e Kushtetutës kërkon si kusht logjik dhe juridik pasjen e statusit të magjistratit, për t’iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.

Në vijim, në rastin e znj. Zhilla, nga verifikimi i akteve të përcjella nga Kolegji në IKP, me datë 5.12.2024, së bashku me parashtrimet e subjektit për seancën e datës 10.12.2024, rezultojnë se znj. Zhilla ka bashkëlidhur dhe kërkesën e bërë në platformën e-Albania, lidhur me daljen e saj në pension, së bashku me numrin e gjurmimit të aplikimit.

Komisioneri Publik konstaton se, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1991, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe tabelave referuese për moshën e daljes në pension, për vitin 2024, është përcaktuar moshja e daljes në pension për gratë 61 vjeç dhe 8 muaj. Nga aktet rezultojnë se znj. Sofia Zhilla ka lindur më datë \*\*.3.1963 dhe, bazuar për sa më sipër referuar, data e pensionit për këtë subjekt është data \*\*.11.2024, në të cilën znj. Zhilla rezultojnë të ketë mbushur moshën 61 vjeç dhe 8 muaj.

Sa më sipër, konstatojmë së znj. Zhilla ka mbush moshën për daljen në pension pleqërie dhe, për rrjedhojë, nuk bën më pjesë në rrethin e subjekteve që duhet t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.

Komisioneri Publik, bazuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit, në kushtet kur aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 nuk kanë parashikuar ndonjë rregullim të posaçëm për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar në rastin e daljes në pension të subjektit të rivlerësimit, vlerëson se, në rastin konkret, objekti dhe qëllimi i këtij procesi është bërë i pamundur dhe nuk mund të vazhdojë në Kolegj, si rrjedhojë, dhe vendimi nr. 767, datë 29.5.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të znj. Zhilla pa një vendim përfundimtar, duhet lënë në fuqi.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**